



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi me numër 12-7949 të datës 24.08.2022, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent.

Lënda me numër 12-7949 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-7949/1 nga 24.08.2022 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për sjellje jo etike të personit zyrtar /// person zyrtar – bashkëpunëtor i punësuar tek parashtruesi me orar pune të pacaktuar. Siç është theksuar në denoncim, personi zyrtar i përmendur më herët ka përfituar interesa personale nga e drejta autoriale, nga /// dhe nga parashtruesi, ka marrë pjesë në konferenca të organizuara nga /// ku promovoi të drejtën e autoriale të vet. Ku në realitet e njëjta i takonte parashtruesit, më pastaj personi zyrtar i theksuar më herët ishte i punësuar në mënyr joligjore dhe kishte marrëdhënie të afërta me drejtorin e mëparshëm të parashtruesit, person zyrtar në ///. nga KSHPK-ja kërkohet që të hulumtohet rasti në përputhej me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit janë dorëzuar prova.

Pas mbikëqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja konstatoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent, Kjo për arsye se në përputhej me nenin 44 paragrafi 6 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave: "personi zyrtar mund të fitojë të ardhura nga veprimtari shkencore, mësimore, kulturore, artistike dhe sportive dhe të ardhura nga e drejta e autorit, patenta dhe të drejta të ngjashme, nga prona intelektuale dhe industriale, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe". Nga ana tjetër, në gjendjen e punëve kur personi zyrtar i treguar ka statusin e nëpunësit administrativ që është i punësuar nga parashtruesi, zbatimi i dispozitave të Kodit për Nëpunësit Administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Moldavisë" Nr. 183/14) është përgjegjësi e nëpunësit administrativ, autoriteti i

parashtruesit të kërkesës, për shkak të të cilit KSHPK-ja konsideroi se nuk ka bazë për të filluar ndonjë veprim në këtë rast konkret.



Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:
- parashtruesi

përgatiti: Mr. D.D
miratoi: Mr. SH.S

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetare,
Katica Nikolovska**

